



EULEX Kosovo dhe Agjenda për Gratë, Paqen dhe Sigurinë



“

“Roli i grave në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) civile është thelbësor. Për të arritur paqe dhe siguri të qëndrueshme, është jetike që të përfshihen të gjithë. Kjo është arsyeja pse agjenda për Gratë, Paqen dhe Sigurnë (GPS) është një fije e argjendtë që e udhëheq qasjen e Misionëve tona ndaj mandateve të tyre përkatëse...

Agjenda për GPS-në siguron që pjesëmarrja kuptimplote dhe e barabartë e grave të sigurohet në të gjitha institucionet dhe proceset e parandalimit të konflikteve, bërjes së paqes, ndërtimit të paqes dhe rehabilitimit pas konfliktit, duke përfshirë reformën e sektorit të sigurisë civile, sundimin e ligjit dhe administratën civile.”

Komandanti i Operacioneve Civile Stefano Tomat

”

Agjenda për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

Agjenda për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS) është një mjet thelbësor për të siguruar që të drejtat, agjencia dhe mbrojtja e grave dhe vajzave të respektohen dhe të mbështeten në çdo kohë.

Në tetor të vitit 2000, **Këshilli i Sigurimit i OKB-së e miratoi rezolutën (KSOKB) 1325**: rezoluta e parë që synon ta njohë efektin joproporcional të konfliktit mbi gratë dhe vajzat dhe të garantojë rëndësinë e kontributit të grave si agjente aktive në angazhimet për paqe dhe siguri.

Këshilli i Sigurimit, me miratimin e Rezolutës 1325 dhe nëntë rezolutave pasuese për gratë, paqen dhe sigurinë, e ka bërë të qartë se **të drejtat e njeriut të grave dhe barazia gjinore janë thelbësore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare**, duke e bërë agjendën për GPS grup instrumentash inovativ për të nxitur një paqe më të barabartë.



Agjenda për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe Bashkimi Evropian

Agjenda për GPS-në është një nga parimet themelore të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian (BE).

BE-ja, si dhe bashkësia më e gjerë ndërkombëtare, ndan qëllimin për ta mbështetur dhe avancuar përfshirjen e grave, përfshirë gratë mbrojtëse të drejtave të njeriut dhe gratë ndërtuese të e paqes, në proceset e paqes dhe sigurisë në të gjitha nivelet, si dhe duke e siguruar mbrojtjen dhe sigurinë tyre. Proceset e paqes duhet të marrin parasysh normat dhe rolet gjinore, si dhe ta analizojnë konfliktin përmes një këndvështrimi gjinor.

Korniza e politikave të BE-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë përfshin Përfundimet e Këshillit të vitit 2018 për Sigurinë Publike (GPS) dhe Qasjen Strategjike të BE-së ndaj GPS-së, Planin e Veprimit përkatës (2019-2027) dhe Përfundimet e Këshillit të vitit 2022 për GPS-në.

BE-ja e zbaton Planin e saj të Veprimit për GPS-në, i cili identifikon objektiva dhe kriterë të qarta përmbushjeje, sipas fushave kryesore prioritare si:



1. Parandalimi

Për t'i parandaluar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në situata të prekura nga konflikti dhe për ta promovuar llogaridhënien dhe për ta kundërshtuar pandëshkueshmërinë për veprimet që prekin gratë në parandalimin e konfliktit.



2. Mbrojtja

Për të siguruar që të drejtat e grave dhe vajzave janë të mbrojtura dhe të promovuara në situata të prekura nga konflikti dhe të kenë mbrojtje nga Dhuna Seksuale në Baza Gjinore (DHSBGJ).



3. Ndhimja dhe rimëkëmbja

Përqendrimi në përmbushjen e nevojave specifike humanitare të grave dhe vajzave gjatë proceseve të riatdhesimit, rivendosjes dhe rimëkëmbjes, duke mbështetur njëkohësisht rolet e tyre si udhëheqëse në reagimin humanitar dhe angazhimet e rindërtimit.

Parimet gjithëpërfshirëse dhe tërthore



4. Pjesëmarrja

Inkurajon gratë që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë me burrat në vendimet/proceset për paqen, politikën dhe sigurinë në nivel kombëtar, lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.



5. Integrimi gjinor

Integrimi gjinor është një strategji që përqendrohet në barazinë gjinore duke marrë parasysh interesat dhe shqetësimet si të grave ashtu edhe të burrave, për ta integruar drejtësinë në institucionet politike-bërëse, institucionet sociale dhe praktikatat kulturore dhe komunitare. Prandaj, integrimi gjinor është një mjet që na ndihmon të zgjidhim pabarazitë që diskriminojnë qasjen e grave në të drejtat e tyre, hapësirën publike ose që përballen me kufizime në mjedisin përreth.



6. Duke qenë shembull

Plani i Veprimit i bën thirrje BE-së që të bëhet shembull, duke përfshirë krijimin e një lidhësi të përgjegjshëm ndaj gjinisë dhe të balancuar nga ana gjinore në nivelet më të larta politike dhe drejtuese.

Përkushtimi i EULEX-it ndaj Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) është Misioni më i madh civil i dislokuar ndonjëherë në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes të BE-së (CSDP), e cila në vetvete është pjesë integrale e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Si i tillë, EULEX-i është i përkushtuar për zbatimin e agjendës për GPS-në në ekzekutimin e mandatit të tij, i cili është mbështetja e institucioneve të përzgjedhura të sundimit të ligjit në Kosovë në rrugën e tyre drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë, shumëetnicitetit dhe llogaridhënies, të lira nga ndërhyrjet politike dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe praktikat më të mira evropiane, përmes aktiviteteve të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit, si dhe funksioneve të kufizuara ekzekutive.

EULEX-i e promovon në mënyrë aktive agjendën për GPS-në dhe parimet e Planit të Veprimit të BE-së me efekte të prekshme në terren. Përmes një integrimi sistematik të perspektivës gjinore, Misioni ndihmon në krijimin e mundësive për politika dhe veprime transformuese gjinore, duke këshilluar dhe trajnuar homologët vendas mbi standardet ndërkombëtare, si dhe duke promovuar përgjigje të përqendruara të viktimat ndaj trajtimit të dhunës seksuale dhe dhunës në baza gjinore.

Duke zbatuar ndërtimin e besimit midis aktorëve të sigurisë dhe popullsisë lokale si një formë thelbësore për sigurimin e barazisë gjinore, EULEX-i përpiqet që ta promovojë pjesëmarrjen dhe fuqizimin kuptimplotë të grave duke u angazhuar në mënyrë aktive me shoqërinë civile dhe organizatat e grave në proceset e reformës së sektorit të sigurisë dhe gjyqësorit.



Veprimet dhe Rezultatet e EULEX- it

EULEX-i vazhdon të jetë i përkushtuar për ta promovuar barazinë gjinore përmes angazhimeve të udhëhequra nga Kosova, që janë projektuar për ta përforcuar pronësinë vendase dhe qëndrueshmërinë e reformave me ndjeshmëri gjinore.

Mbrojtja

Luftimi dhe Parandalimi i Dhunës Seksuale dhe Dhunës në Baza Gjinore (DHSBGJ)

EULEX-i i ndihmon institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë (siç janë Ministria e Drejtësisë, Policia e Kosovës, prokuroria, gjyqësori dhe institucione të tjera relevante) në angazhimet e tyre drejt çrrënjësjes së çdo forme të dhunës seksuale dhe në baza gjinore, si duke i forcuar mekanizmat parandalues ashtu edhe duke e përmirësuar trajtimin e këtyre rasteve nga policia, prokurorët dhe gjyqtarët.



Pas miratimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) nga Kuvendi i Kosovës më 25 shtator 2020, Misioni që atëherë i ka ndihmuar institucionet e Kosovës me:

- ▶ Hartimin e **Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për parandalimin e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Baza Gjinore 2022-2026**, si dhe zbatimin e saj.
- ▶ Përpilimin e një Udhërrëfyese për përmbushjen e kriterëve të Nenit 25 të Konventës së Stambollit, pas të cilit në vitin 2022 me mbështetjen e Misionit u lansua **Protokolli për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale**, kurse në vitin 2023 u mbajtën trajnime për doktorët mjeko-ligjorë, policët, gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët e viktimave mbi zbatimin e Protokollit.
- ▶ Hartimin e **Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore**, i miratuar në shtator 2023, dhe tre prej akteve nënligjore kryesore të tij.
- ▶ Hapjen dhe funksionimin, nga viti 2021, i **18 Dhomave të Intervistimit të Përqendruara të Viktimat në stacionet policore në të gjithë Kosovën** në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës, misionin KFOR të udhëhequr nga NATO dhe Misionin e OSBE-së në Kosovë. Këto hapësira të dedikuara, të sigurta dhe konfidenciale janë thelbësore për intervistimin e viktimave të dhunës me informata mbi traumën dhe janë një hap konkret drejt forcimit të reagimit institucional dhe qasjes në drejtësi.

- ▶ Zhvillimin e punëtorive në vitin 2022, me mbështetjen e OJQ-së Žensko Pravo, e cila merret me të drejtat e grave, për ndërtimin e kapaciteteve për zyrtarët e policisë, gjyqtarët dhe prokurorët për atë se si të adresohet **dhuna psikologjike si një formë e dhunës në familje**.
- ▶ Mbajtjen e një serie seminaresh në vitin 2024 për njëzet zyrtarë policie mbi **luftimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet**.

Përmes **monitorimit të fuqishëm të rasteve të përzgjedhura të DHSBGJ-së** përgjatë gjithë zinxhirit të drejtësisë, duke përfshirë analizën tematike të trendeve dhe modeleve, që ka rezultuar në gjetje dhe rekomandime kryesore për autoritetet përkatëse, EULEX-i e forcon në mënyrë aktive kapacitetin e institucioneve të Kosovës për t'iu përmbajtur detyrimeve të tyre për të drejtat e njeriut.

Konkretisht, në vitin 2022, EULEX-i e publikoi raportin “Vlerësimi i trajtimit të rasteve të përdhunimit nga sistemi i drejtësisë në Kosovë”, bazuar në monitorimin dhe gjetjet e Misionit.

Pjesëmarrja

Fuqizimi i Grave në Institucionet e Sigurisë

EULEX-i vazhdimisht e mbështet rritjen e përfaqësimit të grave në sektorin e sigurisë, duke siguruar përfshirjen aktive të tyre në formësimin e politikave dhe vendimmarrje, si dhe duke forcuar mekanizmat e ofruesve të shërbimeve për t'i pasqyruar më mirë nevojat e komuniteteve të ndryshme.

EULEX-i e ka mbështetur në mënyrë aktive **Shoqatën e Grave në Policinë e Kosovës**, që nga themelimi i saj në vitin 2013, përmes një sërë mundësish për ndërtim kapacitetesh dhe zhvillim profesional, si dhe programeve të mentorimit.



- ▶ EULEX-i ka punuar ngushtë me drejtuesit e lartë të Policisë së Kosovës në hartimin e **Agjendës më të fundit për Barazi Gjinore 2024-2028 të Policisë së Kosovës**, duke promovuar përfshirjen e parimeve ndërsektoriale të Agjendës GPS, përkatësisht integrimin gjinor dhe leadershipin që i përgjigjet nevojave gjinore.
- ▶ Në vitin 2024, me Shoqatën e Grave në Policinë e Kosovës, Misioni i zhvilloi katër **punëtori për ndërtimin e kapaciteteve për të përmirësuar rolet e grave në policim dhe për t'u avancuar në nivelin e vendimmarrjes**.
- ▶ Nga qershori 2025 deri në gusht 2025, Misioni organizoi 19 punëtori për mbi 200 policë meshkuj dhe femra nga të gjitha komunitetet, duke konfirmuar vlerën e mbështetjes së EULEX-it në nxitjen e një **policimi efektiv, të respektueshëm dhe të orientuar drejt komunitetit**.

EULEX-i luajti një rol jetik në themelimin e **Shoqatës së Grave në Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHGSHKK)** në vitin 2018. Që atëherë, EULEX-i e ka mbështetur vazhdimisht funksionimin dhe zhvillimin e saj, si dhe e ka mbështetur hartimin e strategjive të brendshme të saj.

- ▶ Në vitin 2021, Misioni i zhvilloi dy punëtori mbi **“Teknikat e komunikimit/zgjidhjes së problemeve dhe menaxhimin e stresit”** për afërsisht 45 punonjëse femra të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK).
- ▶ Në vitin 2022, EULEX-i e mbështeti SHKK-në në promovimin e një konkursi punësimi për 50 pozita të Zyrtarëve Korrektues Kadetë, të **dedikuara vetëm për kandidatet gra**, në përputhje me Ligjin e Kosovës për Barazi Gjinore.
- ▶ Në vitin 2023, EULEX-i i zhvilloi katër punëtori për 45 pjesëtare të SHGSHKK-së mbi zhvillimin dhe arritjet në karrierë dhe kontribuoi në udhëzimet për mbështetjen e kolegëve për të nxitur një **mjedis pune të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore**.
- ▶ Në vitin 2024, Misioni ofroi **trajnim për sigurinë dinamike** për 47 zyrtare korrektuese femra dhe ndihmoi një seminar për 10 zyrtarë (nëntë femra) për të përmirësuar marrëdhëniet të burgosur-zyrtarë.
- ▶ Në vitin 2024, Misioni monitoroi gjithashtu zgjedhjet e rregullta të SHGSHKK-së dhe mori pjesë në punëtorinë për hartimin e **Strategjisë dhe Planit të Veprimit të SHGSHKK-së 2025-2027**.



Integrimi i perspektivës gjinore dhe parandalimi

Sensibilizimi

Prej vitit 2019, në bashkëpunim me OJQ-të dhe institucionet, EULEX-i i ka **mbështetur angazhimet sensibilizuese për të parandaluar lloje të ndryshme të DHBGJ-së**, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, Fushata 16-ditore e Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave, si dhe fushatat më të fokusuara mbi dhunën psikologjike, të drejtat pronësore dhe dhunën në familje.

Ma thuaj me kohë

Në vitin 2019, në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës (IML), Misioni e nisi fushatën 'Ma thuaj me kohë', që synonte rritjen e sensibilizimit për rëndësinë e **sigurimit të ruajtjes së provave biologjike pas veprave penale të dhunës seksuale**. Pas nisjes së kësaj fushate, u mbajtën disa ligjërata nëpër shkolla fillore dhe të mesme në të gjithë Kosovën për t'i informuar fëmijët lidhur me këtë temë.

S'ka mavijosje ≠ S'ka dhunë

Në vitin 2021, Misioni e nisi fushatën sensibilizuese S'ka Mavijosje ≠ S'ka Dhunë, e cila nxori në pah **abuzimin psikologjik si një formë të dhunës në familje**.

Në vitin 2024, për ta zgjeruar shtrirjen e saj, Misioni sponsorizoi një autobus të transportit publik të Linjës 4 në Prishtinë, të veshur me një thirrje për të mbijetuarit e dhunës në baza gjinore, si dhe për të gjithë qytetarët, që ta **raportojnë DHBGJ dhe dhunën në familje në polici duke telefonuar në numrin 192**.



Edukimi i të rinjve dhe fuqizimi i shoqërisë civile

Për ta përmirësuar parandalimin efektiv të DHSBGJ, EULEX-i, në bashkëpunim me shoqërinë civile të Kosovës, është përqendruar gjithashtu në **edukimin e të rinjve, duke pranuar rolin thelbësor të rinjve si agjentë të ndryshimeve me qëllim ndryshimin e normave dhe mendësive.**

- ▶ Në vitin 2023, Misioni zbatoi **projektin “Fuqizimi i të rinjve kundër dhunës në baza gjinore”** në partneritet me OJQ-në lokale Assist Kosova. Ky projekt synonte parandalimin e dhunës në baza gjinore duke e rritur sensibilizimin tek të rinjtë në Kosovë dhe duke i fuqizuar si vajzat ashtu edhe djemtë me aftësitë dhe njohuritë për të avokuar në mënyrë aktive për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në komunitetet e tyre.
- ▶ Në vitin 2023, Misioni e mbështeti organizatën INTEGRA me **projektin “Ndërtimi i kapaciteteve të shoqërisë civile që zbaton standardet e Konventës së Stambollit”**, që synonte rritjen e sensibilizimit për format dhe mekanizmat mbrojtës për dhunën në familje; si pjesë e këtij projekti u organizuan 14 vizita në terren, duke përfshirë disa komunitete në Kosovë.
- ▶ Në vitin 2024, Misioni, në partneritet me Assist Kosovo, organizoi një aktivitet informues për studentë, mësues dhe profesorë të përqendruar në **diskutimin në panel “Le ta festojmë dhe frymëzojmë përfshirjen”**, i cili u përqendrua në rëndësinë e promovimit të përfshirjes së grave dhe vajzave në të gjitha sferat profesionale dhe shoqërore të jetës, si një element kyç për ta arritur barazinë gjinore dhe për ta ndërtuar një shoqëri prosperuese.



Forcimi i koordinimit midis palëve të interesuara

Si një nga angazhimet e fundit strategjike, në vitin 2025, Misioni nisi një aktivitet të përbashkët EULEX-UNICEF në Kosovë për ta përmirësuar mënyrën se si e adreson Kosova dhunën seksuale dhe abuzimin ndaj fëmijëve, në fushën e drejtësisë dhe zbatimit të ligjit, por edhe në fusha më të gjera qeveritare, sociale dhe arsimore.



Të udhëheqësh me shembull

Gratë në Sundimin e Ligjit: Një rubrikë e EULEX-it që nga viti 2014

Që nga dislokimi i tij, EULEX-i e ka inkurajuar përfshirjen e grave në institucionet e sundimit të ligjit, duke përfshirë edhe në pozita udhëheqëse, si në Kosovë ashtu edhe brenda Misionit.

Në vitin 2014, EULEX-i filloi rubrikën “Gratë në Sundimin e Ligjit”, një përmbledhje me historitë e grave të talentuara. Deri më sot, Misioni i ka publikuar mbi 60 portrete të grave që i përkasin institucioneve të Kosovës, shoqërisë civile dhe pjesëtareve të Misionit.



Women in the Rule of Law



www.eulex-kosovo.eu

